

Data 15.08.2024

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mirëmbajtja e automjeteve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50000000-5;

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,418,903 (shtatë milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tre) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” , në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40 % të fondit limit të marreveshjes kuader.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm

Albanian Gas Service Company Sh.A.

Rruga “Kosovareve”, pallati NderPro Sh.P., Tirana, Albania

NUIS: L82407006D

nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit të limit të Marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të Marrëveshjes kuadër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20 % të fondit limit të MK, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një "kompetencë thelbësore", ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e mirëmbajtjes së automjeteve pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë. Duke qenë se, shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve do të realizohen në serviset e OE dhe gjatë këtij procesi ka disa shërbime që kanë ndikim në mjedis si dhe dalin pjese makina si mbeturina të cilat duhet të menaxhohen sipas rregullave ligjore , është e domosdoshme që operatorët ekonomikë ta disponojnë edhe Standartin ISO 14001:2015 “Sistemi manaxhimit të mjedisit”. Kjo ISO është e lidhur me mjedisin dhe ndihmon në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në lidhje me klientet e saj, komunitetin dhe autoritetet kontraktore. Në të njëjten kohë manaxhimi i duhur i ceshtjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjeve ndihmojnë në rritjen e konkurrencës së shoqërisë shoqëruar me uljen e shpenzimeve. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda më e thjeshtë dhe më efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi manaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO14001.

2.2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me legjislacionin, e fushës në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të

këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2.5 Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar në nenin 41, pika 4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar si dhe në VKM nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Jo cdo subjekt tregtar mund ta ushtroje këto aktivitet, pa u pajisur me *leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B*, pasi procesi i bojatisjes ka impakt të dpd në mjedis ndaj disponimi i kësaj leje nga operatorët ekonomikë është një kërkesë e domosdoshme dhe në proporcion me objektin e prokurimit.

2.2.6 Operatori ekonomik për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 5 (pesë) punonjës sipas profileve si më poshtë:

- 1 (një) motorrist
- 1 (një) xhenerikë
- 1 (një) elektroaut
- 1 (një) bojaxhi,
- 1 (një) gomist

Operatori ekonomik duhet ta provojë disponimin e personelit teknik me profilet e punës të cituara më sipër, nëpërmjet këtij dokumentacioni:

Kontratat individuale të punës, si dhe listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruara në organet tatimore për muajin qershor 2024, ku të jenë të deklaruar këta punonjës sipas profileve të kërkuara si më sipër.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE që shpallet fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe në nenin 41, pika 4/ b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në stafin tyre, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar zërave të shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, bojatisje etj. është e nevojshme që OE të disponojnë një staf teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, bojaxhi. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e tërë automjeteve që do të mirëmbahen, si dhe në natyrën dhe numrin e zërave të shërbimeve që kërkohen të realizohen.

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qira ose huapërdorje të paktën 1 (një) ambjent/servis, me sipërfaqe minimale 100 m², ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Operatori ekonomik duhet ta provojë disponimin e ambjentit nëpërmjet këtij dokumentacioni: Çertifikata e pronësisë ose kontrata e shitblerjes ose kontratë qiraje ose çdo dokument tjetër provues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e ambjentit/servisit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE që shpallet fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar si dhe në nenin 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion 1 (një) ambjent pune/servis ku të ushtrorë aktivitetin e tij të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve me qëllim realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose qira mjetet, pajisjet dhe instrumentet minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) paisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit (fuoristrade).
- b) paisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete;
- c) paisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C;
- d) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;
- e) paisje urë ngritese për automjetet, të paktën 2 (dy) ura;
- f) paisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- g) paisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- h) Repart të riparimit të karrocërisë të mjetit (tapicerisë dhe përpunimit të llamarinës) si dhe bojatisjes së mjetit të pajisur me furre për lyerje me kapacitet për mjetet fuoristrada. Reparti të jetë i kompletuar me pajisjet përkatëse (pajisjes për drejtim llamarinë, puntatrice, aparat saldimit, stukimi, pajisje zmerilimi dhe lucidimi).
- i) Pajisje për drejtim shasie, të cilat të kenë kapacitet në përshtatje të plotë për realizimin e shërbimeve të mjeteve, sikurse kërkohet në specifikimet teknike/termat e references.
- j) Të paktën 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

Operatori ekonomik duhet ta provojë disponimin e pajisjeve dhe mjeteve nëpërmjet këtij dokumentacioni:

- Karrotrecin duhet ta provojë nëpërmjet dorëzimit të lejes së qarkullimit dhe/ose fatura blerjeje dhe/ose kontratave të blerjes/qirasë.
- Pajisjet dhe instrumentet duhet ta provojë nëpërmjet (faturave të blerjes/dokumente zhdoganimi/kontrata qiraje/kontrata huapërdorje/kontrate dhurimi ose çdo dokument tjetër

provues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin mjeteve/pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE që shpallet fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të domosdoshme për të përmbushur kontratën. Bazuar në numrin e automjeteve që disponon AK si dhe në shërbimet e përcaktuara që kërkohen të kryhen janë kërkuar të gjitha pajisjet e nevojshme.

Nisur nga fakti se objekti i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, nder te cilat mund të ndodh që ne raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambientet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht karrotrec me qëllim realizimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.9 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favorët e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike

Termat e Referencës dhe specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën e shërbimit dhe afatin kohor për realizimin e këtij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.